



**INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM**

**QENDRA PËR ÇËSHTJET EUROPIANE & TË SIGURISË**

**RAPORT I SONDAZHIT**

**“Grupet e interesit & Anëtarësimi në BE”**

**Përgatitur nga:**

**Gjergji VURMO, Drejtues i kërkimeve  
Elira HRONI, Studiuuese  
Besjana Kuci, Asistente**

**Tiranë, Prill 2011**

## **PËRMBAJTJA**

HYRJE.....	2
PËRMBLEDHJE.....	3
I. METODOLOGJIA.....	5
II. PËRBËRJA E KAMPIONIT.....	6
III. GJETJET E SONDAZHIT .....	8
III.1. SHKALLA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE QENDRIMI NDAJ ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN EUROPIAN .....	8
III.2. PJESËMARRJA NË PROCESIN E INTEGRIMIT NË BE.....	12
III.3. PRITSHMËRITË NGA PROCESI I INTEGRIMIT NË BE & NGA ADERIMI NË BE .....	14
III.4. ÇFARË DO TË FUNKSIONONTE.....	16
SHTOJCA I. PYETËSORI.....	18

## HYRJE

Anëtarësimi i vendit në BE përbën një nga prioritetet kryesore dhe sfidë domethënëse jo vetëm për institucionet shtetërore por edhe për grupet e ndryshme të interesit. Përfshirja e tyre dhe përfaqësuesve të tjerë jo-shtetërore mbetet thelbësore për cilësinë e procesit, posaçërisht në kontekstin e fazave pasuese nga marrja e statusit dhe negociatat e anëtarësimit. Ndërkohë që pjesa më e madhe e instrumenteve të komunikimit dhe aktiviteteve të ndryshme informuese të aktorëve të ndryshëm që operojnë në Shqipëri janë përqëndruar kryesisht tek prioriteti i “sjelljes së procesit të integrimit europian më pranë qytetarit”, nxitja e përfshirjes së grupeve të interesit dhe informimi i tyre në lidhje me këtë proces duket se është lënë në “harresë”. Për këtë dëshmon jo vetëm shkalla e informimit të tyre në lidhje me procesin e integrimit, siç dëshmonë një pjesë e mirë e studimeve dhe sondazheve, por gjithashtu edhe të dhënat për përfshirjen e tyre në kuadër të përafrimit politikave dhe legjislacionit me atë të BE.

Duke njohur rëndësinë e këtij dimensionit të procesit të integrimit europian të Shqipërisë dhe me synimin për të nxitur mendimin kritik dhe gjenerimin e masave konkrete në funksion të përfshirjes së grupeve të interesit, Qendra për Çështje Europiane & të Sigurisë pranë IDN ka ndërmarrë një vlerësim të perceptimeve dhe eksperiencës së tyre në lidhje me procesin e integrimit europian. Me këtë qëllim, gjatë periudhës Shkurt – Mars 2011 IDN ka kryer një sondazh me 75 grupe të ndryshme interesi (publikë e privatë) dhe aktorë të tjerë jo-shtetërorë të cilët janë përzgjedhur nga një “popullsi” aktorësh që mund të konsiderohen si segment i shoqërisë që jo vetëm ndikohet nga procesi i anëtarësimit të vendit në BE, por gjithashtu mbartin një potencial ndikues thelbësor në këtë proces.

Raporti prezanton gjetjet kryesore të këtij sondazhi i cili nuk pretendon të jetë shterues nga pikpamja e tematikave, proceseve apo aktorëve të përfshirë në anëtarësimin e vendit në BE: Synimi kryesor i analizës së gjetjeve dhe kërkimi i thelluar në këtë aspekt është gjenerimi i debatit të mirë-informuar dhe alternativave konkrete për ikurajimin e përfshirjes dhe kontributit të grupeve të interesit dhe reflektimin adekuat të tyre në kontekstin e antarësimit të vendit në BE.

## PËRMBLEDHJE

Tendencat e pritshmërive, kapaciteteve dhe prioriteteve të grupeve të interesit në kuadër të procesit të anëtarësimit të vendit në BE demonstrojnë në pjesën më të madhe të tyre se kemi të bëjmë me një segment relativisht të mirë-informuar të shoqërisë dhe të hapur për të kontribuar në proceset e reformave. Roli dhe pozita e grupeve të interesit në shoqëri, prioritetet, kapacitetet dhe interesat e tyre shoqërohen gjithashtu edhe me një koncept më të qartë të mënyrave dhe instrumenteve që mundësojnë përmbushjen e tyre. Gjithsesi, duke pasur parasysh kompleksitetin e procesit të integritit evropian dhe ndikimin shumë-dimensional të tij në thujtë të gjithë sektorët e një shoqërie, është e kuptueshme që grupet e interesit përballen me një sërë sfidash ndaj konkretizimit të përfshirjes dhe kontributit të tyre në këtë proces.

Pavarësisht sfidave, paqartësive apo mëdyshjeve **95% e grupeve të interesit e mbështesin plotësisht anëtarësimin** e vendit në BE. **47%** e të anketuarve mendojnë se Shqipëria do të anëtarësohet në BE në periudhën **2014 – 2017** ndërsa **31%** të tjerë besojnë se kjo do të ndodhë midis **2018 – 2020**.

**Mbi 80%** e grupeve të interesit janë të bindur se **anëtarësimi në BE e përmirëson veprimtarinë e sektorit** në të cilin operojnë – ku 45% shprehen se “e përmirëson ndjeshëm” dhe 36% “e përmirëson deri diku”.

Ndryshe nga tendencat që shfaq publiku i gjerë në lidhje me burimet e informacionit, **grupet e interesit shfrytëzojnë burime të diversifikuara për tu informuar** në lidhje me çështje të integritit apo BE në përgjithësi. Media (32%) dhe institucionet e BE (31%) janë dy burimet kryesore të informacionit për to, ndërkohë që institucionet shtetërore dhe organizatat jo-qeveritare gjithashtu shfaqen si burim informacioni për rreth 1/3 e tyre.

Shumica e grupeve të interesit të anketuara deklarojnë se janë **deri diku të informuara me procesin e integritit evropian (41%)** dhe me **zhvillimet brenda BE (47%)**. Më shumë se gjysma (52%) e tyre i kushtojnë vëmendje në vazhdimësi procesit të integritit ndërsa 35% të tjerë thonë se procesit të integritit i kushtohet vëmendje “në varësi nga problematika sektoriale” në fjalë.

Rreth 79% e të intervistuarve kanë **informacion të plotë (58%) ose shumë të plotë (21%) sa i përket ndikimit të anëtarësimit në sektorin ku operojnë**, ndërkohë që 61% e të anketuarve kanë të njëjtin nivel informacioni sa i përket potencialit të tyre për të formëzuar reformat e integritit.

Më shumë se gjysma e të anketuarve (52%), besojnë se sektori në të cilin operojnë duhet të përmirësojë me tej kapacitetet e veta për të përfituar nga avantazhet e të qenit vend anëtar i BE në të ardhmen. **Dy sfidat kryesore** për sektorët përkatës të tyre, para dhe pas anëtarësimit kanë të bëjnë me **“politikat fiskale & kapacitetet përballë konkurrencës”** dhe **“përafrimin me standardet & legjislacionin e BE”**.

Grupet e interesit në shumicën dërrmuese të tyre (83%) e konsiderojnë si “të rëndësishme” (46%) ose “shumë të rëndësishme” (37%) përfshirjen e tyre në procesin e reformave në kuadër të anëtarësimit në BE. Në kontekstin e negociatave të anëtarësimit, shumica e përfaqësuesve të grupeve të interesit **(84%) kërkojnë nga aktorët shtetërore të konsiderohen si “pjesë e pandashme e procesit të negociatave”.**

Pritshmëritë e shumicës së të anketuarve (66%) prej institucioneve shqiptare në kuadër të procesit të integrimit deri në momentin e anëtarësimit lidhen me dy faktorë të ndërlidhur njëri me tjetri - nevoja për **“një ekuilibër të drejtë mes prioriteteve kombëtare & kushteve të anëtarësimit” për 34% të të anketuarve, dhe “një politikëbërje më gjithëpërfshirëse në kuadër të anëtarësimit” për 32% të tjerë.**

Lidhur me format dhe instrumentet e ndryshme për përfshirjen konkrete të grupeve të interesit në procesin e anëtarësimit të vendit në BE, **42.7%** e të anketuarve mendojnë se më efikase do të ishin **“forumet konsultative në bazë sektorësh nën drejtimin e ministrive përkatëse (Qeveria)”**. Një tjetër instrument që do të mundësonte këtë përfshirje – **“këshill kombëtar i anëtarësimit me grupe pune sektoriale nën drejtimin e Kuvendit & me përfshirjen e Qeverisë”** – konsiderohet gjithashtu efikas nga **29.3%** e të anketuarve.

## I. METODOLOGJIA

Sondazhi i zhvillua me 75 përfaqësues të lartë të grupeve të ndryshme të interesit, të përzgjedhur nga një databazë prej rreth 180 aktorësh të tillë. Duke pasur parasysh nivelin e të intervistuarve që sondazhi synoi të përfshijë (drejtues e përfaqësues të lartë të tyre) procesi i anketimit detyrimisht u zgjat në kohë për arsye që kanë të bëjnë me disponibilitetin e të intervistuarve.

Duke qenë të ndërgjegjshëm për këtë sfidë, ekspertët e IDN kanë hartuar një pyetësor i cili është lehtësisht i administrueshëm edhe në mungesë të anketuesit. Nga 75 intervista të realizuara rreth 2/3 e tyre janë realizuar nga anketuesit e IDN kurse pjesa tjetër janë vet-administruar nga të anketuarit të cilët kanë dërguar pyetësorin e plotësuar nëpërmjet postës elektronike.

Pyetësori i përdorur për këtë anketim përbëhej nga 29 pyetje të ndara në pesë seksione të veçanta si më poshtë:

1. Informacion i përgjithshëm
2. Shkalla e ndërgjegjësimit dhe qëndrimet ndaj anëtarësimit në BE
3. Pjesëmarrja në procesin e integritetit në BE
4. Pritshmëritë nga procesi i anëtarësimit dhe nga vetë anëtarësimi në BE
5. një seksion i vepantë i quajtur “Çfarë do të funksiononte...” i cili merr vlerësimet e të anketuarve në lidhje me zgjidhje dhe alternativa të ndryshme mbi përfshirjen e grupeve të interesit.

Nga 29 pyetje që përmban pyetësori, vetëm 2 prej tyre janë pyetje të hapura ndërsa për të tjerat të anketuarve u është kërkuar të zgjedhin opsionet apo të japin vlerësimin e tyre në lidhje me to.<sup>1</sup>

Duke pasur parasysh kapacitetet dhe mundësitë reale të shumicës së grupeve të interesit për përfshirje të qenësishme në proceset politikëbërëse të lidhura me anëtarësimin e vendit në BE, anketimi është fokusuar kryesisht tek aktorët të cilët operojnë në kryeqytet dhe vetëm një numër i kufizuar me grupe interesi që operojnë në qendra të tjera urbane (p.sh. Kukës apo Durrës).

---

<sup>1</sup> Për pyetësorin e plotë shih Shtojcën I të raportit.

## II. PËRBËRJA E KAMPIONIT

Duke u bazuar në përkufizimin që i shih grupet e interesit si një *formë e organizuar anëtarët e së cilës ndajnë qëllime (sociale, ekonomike, politike etj) të përbashkëta dhe punojnë së bashku për të ndikuar politikëbërjen në funksion të përmbushjes së tyre* sondazhi i zhvilluar nga Qendra për Çështje Europiane & të Sigurisë pranë IDN përfshiu 75 grupe të interesit për të cilat plotësojnë një ose më shumë prej kushteve të mëposhtme:


- janë të mirëinformuara në lidhje me procesin dhe / ose nxitin informimin në lidhje me të
- janë kategori të caktuara të cilat kanë (potencialisht) ndikim në procesin e anëtarësimit të vendit në BE ose janë të ndikuara prej këtij procesi dhe eventualisht prej anëtarësimit të vendit në BE

Në këtë kuptim, kampioni i përzgjedhur nga pikpamja e kategorizimit të grupeve të interesit përbëhet nga këto kategori:

Tabela 1. Grupet e interesit të përfshira në sondazh

KATEGORIZIMI I “GRUPEVE TË INTERESIT”	% NDAJ TOTALIT TË KAMPIONIT
Grup ekonomik i interesit (shoqata profesionale, sindikata, sipërmarrje private) <sup>2</sup>	45%
Grupe interesi publik (p.sh. shoqata të qeverisjes vendore, prokurorë etj)	4%
Rrethet akademike	7%
Media	11%
Organizata të Shoqërisë civile (think tanks)	25%
Tjetër <sup>3</sup>	8%

Nga pikpamja **gjinore** e të anketuarve, sondazhi ka siguruar një përfaqësim thuajse të barabartë mes të intervistuarve femra (49%) dhe meshkuj (51%), ndërkohë që nga pikpamje e **grupmoshave**, shumica e të anketuarve (54%) i përkasin grupmoshës nga 26 – 35 vjeç. Në vend të dytë me 16% vijnë të anketuarit që i përkasin grupmoshës 36 – 45, të ndjekur nga grupmosha 18 – 25 vjeç dhe 46 – 55 vjeç me nga 13% respektivisht. Vetëm 3% e të anketuarve i



<sup>2</sup> Anketimi përfshin një numër të konsiderueshëm biznesesh të mëdha dhe të mesme.

<sup>3</sup> Kjo kategori përfshin të anketuar të cilët janë vetëdeklaruar nën këtë nënndarje pasi në gjykimin e tyre nuk mund ta konsideronin institucionin që përfaqësojnë një grup interesi. Raste të tilla të anketuarish përfshijnë shoqata Rome, zyrë avokatie, biznese të vogla apo edhe shoqatë të njëjësive të pushtetit vendor. Në përpunimin e të dhënave të përgjithshme dhe sipas kategorive të të anketuarve, analiza e sondazhit i është përmbytur pikërisht këtij vetëdeklarimi të të anketuarve.

përkasin grupmoshës mbi 56 vjeç ndërsa 1% refuzoi të ofrojë këtë të dhënë.

Duke pasur parasysh se pjesa dërrmuese e të anketuarve i përkasin një gjenerate e cila në 20 vitet e fundit ka pasur mundësi për një përzgjedhje cilësore sa i përket mundësive për tu arsimuar (mbi 80% prej tyre janë të grupmoshave prej 18 - 45 vjeç) të dhënat për **arsimin** e tyre flasin për një kampion të të anketuarish të mirëarsimuar. Shumica e të anketuarve (53.3%) kanë kryer studimet pasuniversitare të nivelit master (45.3%) ose doktoraturë (8%), dhe 44% kanë përfunduar studimet universitare. Vetëm 1.3% prej tyre janë me arsim të mesëm. Shih fig. 1.



### III. GJETJET E SONDAZHIT

Në seksionet e mëposhtme raporti paraqet gjetjet kryesore të sondazhit duke u bazuar në strukturën e pyetësorit të përdorur. Duke pasur parasysh rëndësinë që i jepet në diskursin e përgjithshëm përfshirjes së grupeve ekonomike të interesit (përfshirë operatorët ekonomikë), për të dhëna specifike është kryer gjithashtu edhe një analizë e perceptimeve, qëndrimeve apo pritshmërive të këtij grupi të interesit.

#### III.1. SHKALLA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE QENDRIMI NDAJ ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN EUROPIAN

Është e rëndësishme të theksohet se ndryshe nga tendencat e përgjithshme të qytetarëve të thjeshtë shumica e të cilëve si burim kryesor informacioni shfrytëzojnë “median”, grupet e ndryshme të interesit shfrytëzojnë burime të diversifikuara për tu informuar në lidhje me çështje të integritit apo BE në përgjithësi.<sup>4</sup> Të pyetur mbi burimin kryesor të informacionit, grupet e interesit identifikojnë median (32%) dhe institucionet e BE (31%) si dy burimet kryesore, ndërkohë që rreth 1/3 e tyre konsultojnë institucionet shtetërore (19%) dhe organizatat studimore jo-qeveritare (11%). Rrethet akademike shfrytëzohen vetëm nga 3% e të anketuarve kurse 4% identifikojnë burim “tjetër”.

Sondazhi u kërkoi të anketuarve të vlerësojnë ndikimin e aktorëve të ndryshëm jo-shtetërorë në vend si një instrument që përmirëson procesin e integritit dhe nxit informimin e grupeve të interesit në lidhje me të.

*Pyetje: Si e shihni rolin e këtyre strukturave në përmirësimin e procesit të integritit dhe informimin e grupeve të interesit?*

Tabela 2. Aktorë jo-shtetërorë: Ndikimi tek procesi i integritit & informimi i grupeve të interesit


	Ndikim të madh	Ndikon disi	Nuk ka ndikim	Nuk e di/ Refuzim
Media	81%	19%	-	-
Organizatat studimore të shoqërisë civile	40%	54%	5%	1%
Universitetet	31%	55%	7%	7%

Një shumicë e madhe e të anketuarve (81%) e gjykojnë rolin e medias si një instrument me “ndikim të madh” ndërkohë që për organizatat studimore dhe rrethet akademike, të njëjtin vlerësim japin respektivisht 40% dhe 31% e të anketuarve. Siç shihet edhe nga Tabela 2, për të dy këto kategori më shumë se gjysma e të anketuarve mendojnë se ato “ndikojnë disi”.

<sup>4</sup> Një pjesë e mirë e studimeve të opinionit publik në Shqipëri nënvizojnë se shpeshherë më shumë se gjysma e të anketuarve (qytetarë) e marrin informacionin mbi BE dhe procesin e integritit kryesisht nga media dhe vetëm një pjesë e vogël e tyre shfrytëzojnë burime të tjera informacioni si think tanks, institucione shtetërore, akademike etj.


Më tej, të anketuarit janë pyetur në lidhje me perceptimin e tyre sa i përket shkallës së informimit mbi procesin e integrimit europian të grupit të interesit që ata përfaqësojnë. Shumica (41%) shprehen se institucioni që ata përfaqësojnë mund të konsiderohet si “deri diku i informuar”, ndërkohë që 19% të tjerë deklarojnë se institucioni i tyre është “i informuar vetëm për çështje që lidhen me interesat e sektorit tonë”.

Nga ana tjetër, një shumicë e konsiderueshme prej 39% e të anketuarve e konsiderojnë institucionin e tyre si “shumë të informuar”. Shih Fig 2.




Nëse për të njëjtën çështje shqyrtojmë vetëm përgjigjet e grupeve ekonomike të interesit (operatorë ekonomikë, shoqata biznesi etj.) rezulton se vetëm 15% prej tyre shprehen se janë “shumë të informuar” në lidhje me procesin e integrimit europian. Shumica prej tyre (58%) deklarojnë se janë “deri diku të informuar” dhe pjesa tjetër (27%) janë “të informuar vetëm për çështje që lidhen me sektorin e tyre”.

Të anketuarit janë pyetur gjithashtu edhe për shkallën e informimit të institucioneve që ata përfaqësojnë lidhur me zhvillimet e përgjithshme brenda Bashkimit Europian (BE). Ndërkohë që në përgjigjet e tyre ruhen të njëjtat tendenca si edhe në rastin e pyetjes së mësipërme lidhur me procesin e integrimit europian, ajo që vërehet qartë është fakti se prirjet për një shkallë informimi më të mirë shfaqen në të dobësuar. Kështu, ndërkohë që për procesin e integrimit europian ishin 39% e të anketuarve që ishin “shumë të informuar”, kur pyeten për zhvillimet brenda BE vetëm 29% e tyre deklarojnë të njëjtën gjë. Shumica prej tyre thonë se janë “deri diku të informuar” (47%) ndërsa vetëm 4% deklarojnë se nuk janë aspak të informuar. Shih Figurën 3.



Të pyetur në lidhje me vëmendjen që i kushton institucioni që ata përfaqësojnë, procesit të integrimit europian në përgjithësi, më shumë se gjysma e të anketuarve (52%) deklarojnë se këtij procesi i kushtohet “shumë vëmendje (në vazhdimësi)”. 35% e të anketuarve thonë se procesit të integrimit i kushtohet vëmendje “në varësi nga problematika sektoriale” në fjalë, ndërsa për 9% të tjerë institucioni që përfaqësojnë “i kushton vëmendje por jo rregullisht”. Një grup i vogël prej 3% deklarohet se ky proces “nuk u intereson fare” dhe 1% refuzon të përgjigjet.

Figura 4 paraqet përgjigjet që u dhanë në lidhje me të njëjtën pyetje vetëm nga përfaqësues të grupeve ekonomike të interesit. Ashtu si edhe kampioni i përgjithshëm, edhe kjo kategori të anketuarisht në përgjigjet e veta reflekton të njëjtat tendenca, ku shumica janë të ndarë mes opsionit “shumë vëmendje (në vazhdimësi)” dhe “në varësi nga problematika sektoriale”. Ndryshimi kryesor mes kësaj kategorie dhe tendencave të përgjithshme të kampionit konsiston në faktin se shumica e të anketuarve (rreth 56%) e kushtëzojnë për një arsye apo një tjetër vëmendjen që i kushtojnë procesit të integritimit “në varësi nga problematika sektoriale” (35.3%) ose deklarojnë se “nuk janë të interesuar” (5.9% apo thjesht “nuk i kushtojnë rregullisht vëmendje” (14.7%).




Ndasitë mes të anketuarve duket se kristalizohen më qartë në pyetjen e mëpasshme.

*Pyetje: A janë çështjet e integritimit (reformat, politika, legjislacioni, institucionet) pjesë e diskutimeve periodike në kuadër të veprimtarisë së institucionit tuaj?*

Gati gjysma e të anketuarve (47%) deklarojnë se këto çështje janë “shpesh” pjesë e diskutimeve periodike në kuadër të veprimtarisë së institucionit tuaj, kurse 45% të tjerë kjo ndodh “rrallë”. Shih Figurën 5.

Pavarësisht situatës aktuale mbi informimin apo angazhimin e grupeve përkatëse të interesit të përfshira në sondazh, një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve e njohin dhe e cilësojnë si të rëndësishëm ndikimin e procesit të integritimit europian në aktivitetin ose domain-in e interesave që ata përfaqësojnë, mbrojnë apo promovojnë. Shih Figurën 6.

Duke synuar një identifikim sa më të plotë të shkallës së informimit për aspekte të veçanta që lidhen me procesin e anëtarësimit të vendit në BE sondazhi u kërkoi të anketuarve –



përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit – të vlerësonin nivelin e tyre të informacionit në lidhje me tre çështje kryesore.

*Pyetje: Si do ta gjykonit nivelin tuaj të informacionit në lidhje me çështjet e mëposhtme?*

**Tabela 3: Niveli i informacionit mbi aspekte specifike**

	Shumë i plotë	I plotë	I pakët	Aspak në dijeni
Ndikimi i anëtarësimit në BE në veprimtarinë e sektorit tuaj	21%	58%	20%	1%
Potencialin e sektorit tuaj për të formëzuar reformat në kuadër të integritit	9%	52%	32%	7%
Instrumentet dhe mënyrat e ndikimit të aktorëve të sektorit tuaj në vendim-marrjen/politikë-berjen e BE	4%	39%	48%	9%

Tabela 3 ofron të dhëna domethënëse në lidhje me pozicionin aktual të grupeve të ndryshme të interesit dhe potencialin e tyre për përfshirje përmbytësore në proceset reformuese në kuadër të anëtarësimit të vendit në BE. Rreth 79% e të intervistuarve kanë informacion të plotë (58%) ose shumë të plotë (21%) sa i përket ndikimit të anëtarësimit në sektorin ku ata operojnë. Një shumicë disi më e vogël por sërish e konsiderueshme prej 61% e të anketuarve kanë të njëjtin nivel informacioni sa i përket potencialit të tyre për të formëzuar reformat e integritit. Sidoqoftë, janë jo pak por 39% të cilët kanë informacion të pakët ose nuk kanë fare informacion në lidhje me këtë çështje.

Së fundi, më pak të informuar grupet e interesit shfaqen në lidhje me mënyrat e ndikimit të aktorëve të sektorit të tyre në vendim-marrjen / politikë-berjen e BE – informacion i cili do të përmirësonte ndjeshëm eksperiencën, nivelin e aktivizimit dhe përfshirjes së grupeve shqiptare të interesit në proceset politikë-berëse. Për thujtje gjysmën e të anketuarve ky informacion mbetet i pakët ndërsa 9% deklarojnë se nuk kanë aspak dijeni.


Të pyetur në lidhje me tre aspektet kryesore të procesit të integritit për të cilin të anketuarit kanë më shumë interes, përgjigjet e analizuara reflektojnë kryesisht një tendencë të orientuar drejt aspekteve ekonomike dhe demokratizimit (kriteri politik) si çështjet për të cilat ka më shumë interes. Kështu, nga një total prej 68 përgjigjesh<sup>5</sup> me çështje specifike 51,5% e çështjeve për të cilat ka më shumë interes kanë të bëjnë me aspekte të integritit ekonomik, tregut të përbashkët dhe zhvillimit ekonomik. 26.5% e përgjigjeve përcaktojnë aspekte që kanë të bëjnë me demokratizimin, kriterin politik dhe përafrimin me standardet dhe legjislacionin e BE. Më pak të “klikuara” janë çështjet që kanë të bëjnë me lëvizjen e lirë të njerëzve (7.3%), bashkëpunimi me organizata partnere në BE & asistencë financiare për projekte (8.8%) apo mundësitë për arsim dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor (5.9%).

Pavarësisht sfidave, paqartësive apo mëdyshjeve 95% e përfaqësuesve të anketuar të grupeve të interesit e mbështesin plotësisht anëtarësimin e vendit në BE, ndërsa 4%

<sup>5</sup> Jo të gjithë të anketuarit i janë përgjigjur kësaj pyetje të hapur ndërsa nga ata që janë përgjigjur, shumica kanë ofruar vetëm 1 ose dy çështje specifike.

shprehen se “nuk janë të sigurt” dhe 1% refuzon të përgjigjet. Asnjë prej të anketuarve nuk është kundër apo indiferent ndaj anëtarësimit të Shqipërisë në BE .


47% e të anketuarve mendojnë se Shqipëria do të anëtarësohet në BE në periudhën 2014 – 2017 ndërsa 31% të tjerë besojnë se kjo do të ndodhë midis 2018 – 2020. 7% prej tyre shprehen se vendi nuk do të anëtarësohet kurrë në BE. Opsionet “brenda 2013ës” dhe “pas 2020ës” si data të mundshme të anëtarësimit kanë marrë nga 8% respektivisht të pritshmërive të të anketuarve. Shih Figurën 7.



### III.2. P.JESËMARRJA NË PROCESIN E INTEGRIMIT NË BE

Grupet e interesit në shumicën dërrmuese të tyre (83%) e konsiderojnë si “të rëndësishme” (46%) ose “shumë të rëndësishme” (37%) përfshirjen e tyre në procesin e reformave në kuadër të anëtarësimit në BE. Vetëm 9% e shohin si “pak të rëndësishme” këtë përfshirje dhe 5% të tjerë si “aspak të rëndësishme”, ndërkohë që 3% refuzojnë të përgjigjen.

Duke pasur parasysh strukturën, interesat dhe prioritetet e ndryshme të secilës kategori të grupeve të interesit (private, publike apo civile), të anketuarit shfaqen të ndarë në lidhje me pyetjen se në cilin prej stave të reformave të procesit të integrimit përfshirja e tyre do t'i shërbente më shumë interesave të grupit që përfaqësojnë, gjykuar nga këndvështrimi i interesave respektive. Rreth 1/3 e tyre




e shohin si më të favorshme përfshirjen në të gjitha stadet e proceseve politikëbërëse. 25% besojnë se përfshirja që në fazat fillestare të politikëbërjes ofron më shumë avantazhe ndërsa 20% zgjedhin monitorimin e zbatimit të kuadrit të politikave dhe

legjislacionit dhe 12% të tjera atë të vlerësimit të performancës së institucioneve. Shih Figurën 8.

Renditja e opsioneve më sipër mbi përfshirjen në stadi të ndryshme të proceseve reformuese shfaqet diametralisht e kundërt kur të anketuarit pyeten për eksperiencën e deritanishme. Kështu, ndërkohë që “përfshirjen në të gjitha stadiet” (shih më sipër) e shohin si të favorshme për interesat e tyre shumica (31%) e të anketuarve, në eksperiencën e deritanishme rreth 35% e tyre shprehin se nuk kanë qenë të përfshirë në asnjë stad ndërsa vetëm 8% të tjerë deklarojnë se kanë qenë të përfshirë në ciklin e plotë të politikave.

E njëjta përqindje e të anketuarve shprehin se kanë qenë të përfshirë në “monitorimin e zbatimit të politikave / legjislacionit” (8%) ose në “vlerësimin e performancës së institucioneve” (8%). I vetmi përjashtim nga mospërputhja mes përparësisë që i jepet dhe eksperiencës së deritanishme ka të bëjë me stadi fillestare të politikëbërjes – hartimi i politikave & legjislacionit – në të cilin janë po aq (25%) e të anketuarve të cilët shprehin se kanë



qenë të përfshirë në këtë stad. Shih Figurën 9.


Duke u fokusuar vetëm tek përgjigjet e dhëna nga të anketuar – përfaqësues të grupeve ekonomike të interesit, vërehet se tendencat e kampionit të përgjithshëm ruhen përgjithësisht të njëjta edhe në rastin e grupeve ekonomike të interesit të marra më vete. Kështu, shumica e të anketuarve të kësaj kategorie (40%) në eksperiencën e deritanishme nuk është përfshirë në asnjë prej këtyre stadi. Menjëherë pas këtij opsioni për nga përgjigjet e dhëna, renditet stadi fillestar (hartimi i politikave/legjislacionit) ku deklarojnë se janë përfshirë 21% e kësaj kategorie. Përfshirja në “vlerësimin e performancës së institucioneve” ka ndodhur për 9% të të anketuarve dhe po aq (9%) kanë qenë të përfshirë “në të gjithë stadiet”, ndërkohë që vetëm 3% deklarojnë se kanë qenë të përfshirë në “vlerësimin e performancës së institucioneve” (15% të tjerë refuzojnë të përgjigjen dhe 3% deklarojnë se kanë qenë të përfshirë në ndonjë stad / proces tjetër).

Një, nga moria e arsyeve, për këtë situatë të përfshirjes së grupeve të interesit në procesin e reformave në kuadër të anëtarësimit në BE shfaqet edhe informacioni i varfër që këto grupe interesi disponojnë në lidhje me eksperiencën e grupeve të ngjashme të interesit në vendet e BE. Të pyetur nëse disponojnë informacion mbi përfshirjen e institucioneve të ngjashme në vendet europiane në vendim-marrjen dhe politikë-bërjen e BE – rreth 55% e

të anketuarve deklarojnë se kanë informacion të pjesshëm dhe 19% të tjerë nuk kanë aspak informacion. Vetëm 15% e të anketuarve shprehen se kanë informacion të plotë, ndërsa 11% refuzojnë të përgjigjen.

Gjithsesi, duket se një pjesë e mirë e grupeve të interesit kanë interes për të mësuar nga eksperiencia e partnerëve të tyre në vendet e BE duke ndërmarrë iniciativa për vendosjen e bashkëpunimit me to. 41% e të anketuarve deklarojnë se institucioni që përfaqësojnë ka ndërmarrë iniciativa të tilla ndonëse jo në mënyrë të rregullt (“nganjëherë”) dhe 17% të tjerë shprehen se “kanë ndërmarrë shpesh” hapa për vendosjen e bashkëpunimit. Nuk kanë tentuar asnjëherë në këtë drejtim 17% e totalit të të anketuarve ndërsa 25% të tjerë nuk kanë informacion ose refuzojnë të përgjigjen.

Së fundi, në kontekstin e fazës pasuese të procesit të integrimit europian – negociatat e anëtarësimit – shumica e përfaqësuesve të grupeve të interesit (84%) kërkojnë nga aktorët shtetërore të konsiderohen si “pjesë e pandashme e procesit të negociatave”. Shih Figurën 10.




### III.3. PRITSHMËRITË NGA PROCESI I INTEGRIMIT NË BE & NGA ADERIMI NË BE

Vetëm 4% e të anketuarve e shohin procesin e integrimit europian si një angazhim që duhet të sillt më pranë dhe të përfshijë qytetarët. 23% e tyre gjykojnë se tërësia e procesit duhet t’i prezantohet dhe të përfshijë grupet e interesit. Përkundër këtyre dy grupimeve dhe rreth 1% e të anketuarve që refuzojnë përgjigjen, qëndron një shumicë e konsoliduar të anketuarish prej 72% të cilët e shohin si një proces që duhet të përfshijë njëherësh qytetarët dhe grupet e interesit së bashku.

Pritshmëritë e shumicës së të anketuarve (66%) prej institucioneve shqiptare në kuadër të procesit të integrimit deri në momentin e anëtarësimit lidhen me dy faktorë të ndërlidhur njëri me tjetri - nevoja për “një ekuilibër të drejtë mes prioriteteve kombëtare & kushteve të anëtarësimit” për 34% të të anketuarve, dhe “një politikëbërje më gjithëpërfshirëse në kuadër të anëtarësimit” për 32% të tjerë. 17% e të anketuarve shprehen në mënyrë akoma më të drejtpërdrejtë duke shpresuar për një “bashkëpunim të vazhdueshëm & konstruktiv me përfaqësuesit e sektorit privat”, ndërkohë që 15% e përfaqësuesve të grupeve të


interesit “nuk kanë pritshmëri të larta” prej institucioneve shqiptare në këtë proces (1% refuzojnë të përgjigjen).

Nëse analizohen vetëm përgjigjet e grupeve ekonomike të interesit lidhur me këtë pyetje, ajo çka vërehet është një ndarje mjaft e përafërt mes katër opsioneve lidhur me pritshmëritë e të anketuarve prej institucioneve shqiptare. Siç shihet edhe nga Figura 11, diferencat e tyre nga njëri option tek tjetri variojnë nga 2% deri në 8% çka e bën të vështirë identifikimin e një kategorie pritshmërisht me më shumë mbështetje nga të anketuarit. Është e rëndësishme të theksohet se përqindja e të anketuarve të kësaj kategorie të cilët “nuk kanë pritshmëri të larta” është më e madhe (kap shifrën e 21%) sesa tendenca e përgjithshme e kampinit (15%).



Mbi 80% e të anketuarve janë të bindur se anëtarësimi në BE përgjithësisht e përmirëson veprimtarinë e sektorit në të cilin operojnë – ku 45% shprehen se “e përmirëson ndjeshëm” dhe 36% “e përmirëson deri diku”. Më dyshues në këtë aspekt shfaqet një numër i kufizuar të anketuarish që mendojnë se anëtarësimi e vështirëson “ndjeshëm” (3%) apo “deri diku” (4%) ose gjykojnë se “nuk ka ndikim” mbi veprimtarinë e sektorit të tyre (7%). 5% e të anketuarve kanë refuzuar të përgjigjen ndaj kësaj pyetje.

Më shumë se gjysma e të anketuarve (52%), besojnë se sektori në të cilin operojnë duhet të përmirësojë me tej kapacitetet e veta për të përfutur nga avantazhet e të qenit vend anëtar i BE në të ardhmen. Më shumë se 1/3 besojnë se disponojnë të gjithë kapacitetet e duhura dhe 8% shprehen se mungojnë kapacitetet në këtë drejtim. Shih Figurën 12.



Nëse analizojmë përgjigjet e grupeve ekonomike të interesit lidhur me të njëjtën pyetje vërejmë se kjo kategori shfaqet



e dyzuar mes opsionit se sektori i tyre i disponon “plotësisht” kapacitetet e duhura (44%) dhe “pjesërisht, ka nevojë për përmirësim” (sipas 41% prej tyre)

Së fundi, të anketuarit janë pyetur në lidhje me sfidën kryesore para dhe pas anëtarësimit në BE për sektorin në të cilin operojnë sipas gjykimit të tyre. Nëse analizojmë sfidat e identifikuar para anëtarësimit – nga një total prej 17 përgjigjesh (17 të anketuar), “politika fiskale & kapacitetet përballë konkurrencës” janë sfida më e madhe për 8 prej tyre (47%). Rreth 30% të tjerë gjykojnë “përafrimin me standardet & legjislacionin e BE” si sfidën kryesore dhe pjesa tjetër (23%) identifikojnë “aspekte të tjera” si informimi dhe konsultimi i grupeve të interesit apo bashkëpunimi me partnerët europianë.

E njëjta strukturë dhe llojshmëri sfidash është identifikuar nga të anketuarit edhe kur pyeten për fazën pas anëtarësimit. I vetmi ndryshim konsiston në faktin se kategorizimi i 18 sfidave të identifikuar reflekton një numër të barabartë përgjigjesh për secilën kategori: “politika fiskale & kapacitetet përballë konkurrencës” (6 të anketuar); “përafrimin me standardet & legjislacionin e BE” (6 të anketuar); dhe “aspekte të tjera” (6 të anketuar).

### **III.4. ÇFARË DO TË FUNKSIONONTE...**

Duke sjellë në vëmendjen e të anketuarve eksperiencën aktuale, instrumentet dhe modalitetet e mundshme për nxitjen e përfshirjes së tyre dhe bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse, seksioni i fundit i anketimit tenton të identifikojë qëndrimet e grupeve të interesit në lidhje me këto çështje parë nga këndvështrimi i stadi aktual dhe atyre pasues të procesit të anëtarësimit të vendit në BE.

Përgjithësisht të anketuarit shfaqen disi skeptikë sa i përket përqaesjes së institucioneve për të reflektuar kontributin e grupeve të interesit në axhendën e procesit të integritimit.

*Pyetje: A keni besim se kontributi i grupeve të interesit në procesin e integritimit do të reflektohet nga institucionet shqiptare në axhendën e procesit të integritimit?*

67% e të anketuarve mendojnë se ky kontribut do të reflektohet “deri diku” dhe 9% “aspak”. Vetëm 16% shfaqen optimistë duke besuar se kontributi i tyre “do të reflektohet plotësisht” në axhendën e integritimit. 8% nuk kanë mendim në lidhje me këtë pyetje.

Përgjithësisht të njëjtat tendenca vërehen edhe në lidhje me pyetjen vijuese – “Në vlerësimin tuaj, a mendoni se institucionet shqiptare do të jenë të hapura për tu konsultuar me grupet e interesit në kuadër të negociatave të anëtarësimit?” 65% mendojnë se kjo do të ndodhë “deri në njëfarë mase”, 13% “aspak” dhe vetëm 15% deklarojnë “po, plotësisht” (7% refuzojnë të përgjigjen).

Lidhur me instrumentet dhe modalitetet e ndryshme që mund të nxitin përfshirjen e grupeve të interesit në formëzimin e reformave dhe masave ligjore në kuadër të procesit të integritimit të anketuarit shfaqen më shumë mbështetës ndaj strukturave të cilat drejtohen nga Ekzekutivi ose të cilat kanë minimalisht përfshirjen e tyre.

*Pyetje: Cili do të ishte opsioni më efikas për bashkëpunimin midis institucioneve shtetërore dhe jo-shtetërore për përfshirjen e kontributit të grupeve të interesit në kuadër të procesit të integritimit?*


Siç shihet edhe nga Figura 12, shumica e të anketuarve (42.7%) mendojnë se më efikase do të ishin “forumet konsultative në bazë sektorësh nën drejtimin e ministrive përkatëse (Qeveria)”. Opsioni i dytë për nga mbështetja e përfaqësuesve të grupeve të interesit të anketuar është “këshill kombëtar i anëtarësimit me grupe pune sektoriale nën drejtimin e Kuvendit & me përfshirjen e Qeverisë” (29.3%). Është interesant fakti se grupet e interesit shfaqen më

shumë mbështetës për struktura

gjithëpërfshirëse

(forum apo këshill) që mblidhen rregullisht sesa për mundësi të tjera (si “takime periodike me Kryeministrin & Ministrin e Integritimit” – 4%) apo instrumente të tjera ekzistuese

(pjesëmarrje në diskutimet e Komisioneve parlamentare sipas problematikës – 9.3%).



# SHTOJCA I. PYETËSORI



## INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM QENDRA PËR ÇËSHJTJE EUROPIANE & TË SIGURISË

### PYETËSOR

#### Grupet e interesit & Anëtarësimi në BE

Anëtarësimi i vendit në BE përbën një nga prioritetet kryesore dhe sfidë domethënëse jo vetëm për institucionet shtetërore por edhe për grupet e interesit. Përfshirja e tyre dhe përfaqësuesve të tjerë jo-shtetërore mbetet thelbësore për cilësinë e procesit, posaçërisht në kontekstin e fazave pasuese nga marrja e statusit dhe negociatat e anëtarësimit. Nën këtë këndvështrim, Qendra për Çështje Europiane & të Sigurisë pranë IDN ka ndërmarrë një vlerësim të perceptimeve dhe eksperiencës së grupeve të ndryshme të interesit në Shqipëri në lidhje me procesin e integritimit evropian. Analiza e gjetjeve dhe kërkimi i thelluar në këtë aspekt do të ofrojë alternativa konkrete për inkurajimin e përfshirjes dhe kontributit të grupeve të interesit dhe reflektimin adekuat të tyre në kontekstin e anëtarësimit të vendit në BE.

### I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

#### 1. Gjinia

1.  Femër
2.  Mashkull

#### 2. Moshë:

18 – 25 vjeç	1 <input type="checkbox"/>
26- 35 vjeç	2 <input type="checkbox"/>
36 – 45 vjeç	3 <input type="checkbox"/>
46 – 55 vjeç	4 <input type="checkbox"/>
Mbi 56 vjeç	5 <input type="checkbox"/>
Nuk e di /refuzim	99

#### 3. Arsimi:

Arsim i mesëm	1 <input type="checkbox"/>
Studime universitare	2 <input type="checkbox"/>
Studime pas-universitare – nivel Master	3 <input type="checkbox"/>
Studime pas-universitare – nivel Doktoraturë	4 <input type="checkbox"/>

Nuk e di /refuzim	99
-------------------	----

#### 4. Kategorizimi profesional

Grup ekonomik i interesit (shoqata profesionale, biznesi, sindikata, sipërmarrje private etj.)	1 <input type="checkbox"/>
Grupe interesi publik (p.sh. shoqata të qeverisjes vendore, prokurorë etj)	2 <input type="checkbox"/>
Rrethet akademike	3 <input type="checkbox"/>
Media	4 <input type="checkbox"/>
Organizata të shoqërisë civile	5 <input type="checkbox"/>
Tjetër (Specifiko: _____)	6 <input type="checkbox"/>

## II. SHKALLA E NDËRGJEGJËSIMIT & QENDRIMI NDAJ ANËTARËSIMIT NË BE

### 5. Sa të informuar e konsideroni institucionin tuaj në lidhje me procesin e integrimit europian të Shqipërisë?

Shumë të informuar	1 <input type="checkbox"/>
Deri diku të informuar	2 <input type="checkbox"/>
Të informuar vetëm për çështje që lidhen me interesat e sektorit tonë	3 <input type="checkbox"/>
Aspak të informuar	4 <input type="checkbox"/>
Nuk e di / Refuzim	99 <input type="checkbox"/>

### 6. Sa vëmendje i kushton institucioni juaj procesit të integrimit europian në përgjithësi?

Shumë vëmendje (në vazhdimësi)	1 <input type="checkbox"/>
Varet nga problematika sektoriale	2 <input type="checkbox"/>
I kushton vëmendje por jo rregullisht	3 <input type="checkbox"/>
Nuk na intereson	4 <input type="checkbox"/>
Nuk e di / Refuzim	99 <input type="checkbox"/>

### 7. A janë çështjet e integrimit (reformat, politika, legjislacioni, institucionet) pjesë e diskutimeve periodike në kuadër të veprimtarisë së institucionit tuaj?

Po, shpesh	1 <input type="checkbox"/>
Po, por rrallë	2 <input type="checkbox"/>
Jo, asnjëherë	3 <input type="checkbox"/>
Nuk e di / Refuzim	99 <input type="checkbox"/>

### 8. Sipas gjykimit tuaj, sa ndikim ka procesi i integrimit europian në aktivitetin ose domain-in e interesave që ju përfaqësoni, mbron apo promovoni?

Ndikim të madh	1 <input type="checkbox"/>
Ndikim disi	2 <input type="checkbox"/>
Nuk ka aspak ndikim	3 <input type="checkbox"/>
Nuk e di / Refuzim	99 <input type="checkbox"/>

### 9. Sa të informuar e konsideroni institucionin tuaj në lidhje me zhvillimet e ndryshme në BE në përgjithësi?

Shumë të informuar	1 <input type="checkbox"/>
Deri diku të informuar	2 <input type="checkbox"/>
Të informuar vetëm për çështje që lidhen me interesat e sektorit tonë	3 <input type="checkbox"/>
Aspak të informuar	4 <input type="checkbox"/>

Nuk e di / Refuzim	99 <input type="checkbox"/>
--------------------	-----------------------------

**10. Cili është burimi juaj kryesor i informacionit në lidhje me dinamikën e procesit të integrimit europian dhe Bashkimin Europian në përgjithësi?  
VETËM NJË PËRGJIGJE!**

Institucionet shtetërore	1 <input type="checkbox"/>
Institucionet e BE-së	2 <input type="checkbox"/>
Organizatata studimore jo-qeveritare (vendase & të huaja)	3 <input type="checkbox"/>
Mediat	4 <input type="checkbox"/>
Rrethet akademike	5 <input type="checkbox"/>
Tjetër (specifiko): _____	6 <input type="checkbox"/>
Nuk e di / Refuzim	99 <input type="checkbox"/>

**11. Si do ta gjykonit nivelin tuaj të informacionit në lidhje me çështjet e mëposhtme?  
JU LUTEM VLERËSONI SECILËN PËR ÇËSHTJEVE!**

	Shumë i plotë 1 <input type="checkbox"/>	I plotë 2 <input type="checkbox"/>	I pakët 3 <input type="checkbox"/>	Aspak në dijeni 4 <input type="checkbox"/>
Ndikimi i anetaresimit në BE në veprimtarinë e sektorit tuaj				
Potencialin e sektorit tuaj për të formëzuar reformat në kuadër të integrimit				
Instrumentet dhe mënyrat e ndikimit të aktorëve të sektorit tuaj në vendim-marrjen/politikë-berjen e BE				

**12. Cilat janë tre prej aspekteve të integrimit europian për të cilat keni më shumë interes?**

- 1.....
- 2.....
- 3.....

**13. A e mbështesni anëtarësimin e Shqipërisë në BE?**

Po, plotësisht	1 <input type="checkbox"/>
Jo, aspak	2 <input type="checkbox"/>
Nuk jam i sigurt	3 <input type="checkbox"/>
Nuk më intereson	4 <input type="checkbox"/>
Refuzim	99 <input type="checkbox"/>

**14. Kur mendoni se Shqipëria do të anëtarësohet në BE?**

Brenda 2013	1 <input type="checkbox"/>
2014 – 2017	2 <input type="checkbox"/>
2018 - 2020	3 <input type="checkbox"/>
Pas 2020	4 <input type="checkbox"/>
Kurrë	5 <input type="checkbox"/>
Nuk e di / Refuzim	99 <input type="checkbox"/>

### III. PJESËMARRJA NË PROCESIN E INTEGRIMIT NË BASHKIMIN EUROPIAN

**15. Sa të rëndësishme e gjykoni përfshirjen e institucionit tuaj në procesin e reformave dhe politikë-bërjes në lidhje me anëtarësimin e vendit në BE?**

Shumë të rëndësishme	1 <input type="checkbox"/>
Të rëndësishme	2 <input type="checkbox"/>
Pak të rëndësishme	3 <input type="checkbox"/>
Aspak të rëndësishme	4 <input type="checkbox"/>
Nuk e di / Refuzim	99 <input type="checkbox"/>

**16. Parë nga këndvështrimi i interesave tuaja profesionale, në cilin stad të reformave të procesit të integrimit mendoni se përfshirja juaj do t'i shërbente më shumë interesave të grupit që ju përfaqësoni (bëni pjesë)?**

*VETËM NJË PËRGJIGJE!*

Hartimi i politikave dhe legjislacionit (përafrimi me standardet e BE)	1 <input type="checkbox"/>
Monitorimi i zbatimit të kuadrit të politikave & legjislacionit	2 <input type="checkbox"/>
Vlerësimi i performancës së institucioneve	3 <input type="checkbox"/>
Stad tjetër (specifiko): _____	4 <input type="checkbox"/>
Në të gjitha sa me sipër	5 <input type="checkbox"/>
Në asnjë prej tyre	6 <input type="checkbox"/>
Nuk e di / refuzim	99 <input type="checkbox"/>

**17. Nisur nga eksperiencia e deritanishme, në cilin prej stadeve të mëposhtme në kuadër të integrimit europian jeni përfshirë rregullisht nga institucionet e vendit?**

*VETËM NJË PËRGJIGJE!*

Hartimi i politikave dhe legjislacionit (përafrimi me standardet e BE)	1 <input type="checkbox"/>
Monitorimi i zbatimit të kuadrit të politikave & legjislacionit	2 <input type="checkbox"/>
Vlerësimi i performancës së institucioneve	3 <input type="checkbox"/>
Tjetër (specifiko): _____	4 <input type="checkbox"/>
Në të gjitha sa me sipër	5 <input type="checkbox"/>
Në asnjë prej tyre	6 <input type="checkbox"/>
Nuk e di / refuzim	99 <input type="checkbox"/>

**18. A keni informacion mbi përfshirjen e institucioneve të ngjashme si ju në vendet europiane në vendim-marrjen dhe politikë-bërjen e BE?**

Po, informacion shumë të plotë	1 <input type="checkbox"/>
Po, informacion të pjesshëm	2 <input type="checkbox"/>
Aspak informacion	3 <input type="checkbox"/>
Nuk e di / Refuzim	99 <input type="checkbox"/>

**19. A kanë ndërmarrë grupet e interesit në sektorin tuaj iniciativa për vendosjen e bashkëpunimit për çështje të integrimit me institucione të ngjashme në BE?**

Po, shpeshherë	1 <input type="checkbox"/>
Nganjëherë	2 <input type="checkbox"/>
Jo, asnjëherë	3 <input type="checkbox"/>
Nuk e di / Refuzim	99 <input type="checkbox"/>

**20. Shqipëria pret të hapë negociatat e anëtarësimit me BE. A mendoni se institucionet shqiptare duhet të konsultohen me grupet e ndryshme të interesit në vend në lidhje me to?**

Grupet e interesit duhet të jenë pjesë e pandashme e këtij procesi në tërësi	1 <input type="checkbox"/>
Jo aspak – anëtarësimi dhe negociatat janë përgjegjësi e aktorëve shtetërore	2 <input type="checkbox"/>
Vetëm nëse institucionet shqiptare e gjykojnë të nevojshme	3 <input type="checkbox"/>
Nuk jam i sigurt	4 <input type="checkbox"/>
Nuk e di / Refuzim	99 <input type="checkbox"/>

#### IV. PRITSHMËRITË NGA PROCESI I INTEGRIMIT NË BE & ADERIMI NË BE

**21. A mendoni se tërësia e procesit të integrimit europian duhet të jetë mbi të gjitha një angazhim që duhet të sillet më pranë dhe të përfshijë:**

*VETËM NJË PËRGJIGJE!*

Qytetarët e thjeshtë	1 <input type="checkbox"/>
Grupet e ndryshme të interesit (biznesi, shoqëria civile, media etj)	2 <input type="checkbox"/>
Të dyja bashkë	3 <input type="checkbox"/>
As njëra as tjetra (është thjesht një objektiv i politikës)	4 <input type="checkbox"/>
Tjetër (specifiko): _____	5 <input type="checkbox"/>
Nuk e di / refuzim	99 <input type="checkbox"/>

**22. Çfarë prisni prej institucioneve shqiptare në kuadër të procesit të integrimit (deri në momentin e anëtarësimit)**

*VETËM NJË PËRGJIGJE!*

Nje politikë-bërje më gjithëpërfshirëse në kuadër të anëtarësimit	1 <input type="checkbox"/>
Bashkëpunim i vazhdueshëm & konstruktiv me përfaqësuesit e sektorit privat	2 <input type="checkbox"/>
Ekulibër i drejtë midis interesave të vendit dhe kërkesave të anëtarësimit	3 <input type="checkbox"/>
Nuk kam pritshmëritë të larta	4 <input type="checkbox"/>
Tjetër (specifiko) _____	5 <input type="checkbox"/>
Nuk e di / refuzim	99 <input type="checkbox"/>

**23. Cila është sfida kryesore për institucionin / sektorin tuaj në kuadër të procesit të integrimit? Po pas anëtarësimit?**

Para anëtarësimit: \_\_\_\_\_

Pas anëtarësimit: \_\_\_\_\_

**24. Më konkretisht, a mendoni se anëtarësimi i vendit në BE do ta përmirësojë apo vështirësojë veprimtarinë e sektorit që ju / institucioni juaj mbulon?**

E përmirëson ndjeshëm	1 <input type="checkbox"/>
E përmirëson, deri diku	2 <input type="checkbox"/>
Nuk ka ndikim	3 <input type="checkbox"/>
E vështirëson ndjeshëm	4 <input type="checkbox"/>
E vështirëson deri diku	5 <input type="checkbox"/>
Nuk e di / refuzim	99 <input type="checkbox"/>

**25. A mendoni se (aktorët e) sektori juaj i ka kapacitetet e nevojshme për të përfituar nga avantazhet e të qenit vend anëtar i BE?**

Po, plotësisht	1 <input type="checkbox"/>
----------------	----------------------------

Pjesërisht, ka nevojë për përmirësime	2 <input type="checkbox"/>
Kapacitetet mungojnë	3 <input type="checkbox"/>
Nuk e di / refuzim	99 <input type="checkbox"/>

## V. ÇFARË DO TË FUNKSIONONTE...

**26. A keni besim se kontributi i grupeve të interesit në procesin e integritit do të reflektohet nga institucionet shqiptare në axhendën e procesit të integritit?**

Po, plotësisht	1 <input type="checkbox"/>
Deri diku	2 <input type="checkbox"/>
Aspak	3 <input type="checkbox"/>
Nuk e di	99 <input type="checkbox"/>

**27. Në vlerësimin tuaj, a mendoni se institucionet shqiptare do të jenë të hapura për tu konsultuar me grupet e interesit në kuadër të negociatave të anëtarësimit?**

Po plotësisht.	1 <input type="checkbox"/>
Deri në një fare mase	2 <input type="checkbox"/>
Jo, aspak	3 <input type="checkbox"/>
Nuk e di / Refuzim	99 <input type="checkbox"/>

**28. Cili do të ishte opsioni më efikas për bashkëpunimin midis institucioneve shtetërore dhe jo-shtetërore për përfshirjen e kontributit të grupeve të interesit në kuadër të procesit të integritit?**

*VETËM NJË PËRGGJIGJE!*

Forume konsultative në bazë sektorësh nën drejtimin e ministrive përkatëse (Qeveria)	1 <input type="checkbox"/>
Një këshill kombëtar i anëtarësimit me grupe pune sektoriale (në bazë sektorësh) nën drejtimin e Kuvendit & me përfshirjen e Qeverisë	2 <input type="checkbox"/>
Takime periodike me Kryeministrin dhe Ministrin e Integritit	3 <input type="checkbox"/>
Pjesëmarrje në diskutimet e komisioneve parlamentare sipas problematikës	4 <input type="checkbox"/>
Tjetër (specifiko): _____	5 <input type="checkbox"/>
Nuk e di / Refuzim	99 <input type="checkbox"/>

**29. Si e shihni rolin e këtyre strukturave në përmirësimin e procesit të integritit dhe informimin e grupeve të interesit?**

	Ndikim të madh 1 <input type="checkbox"/>	Ndikon disi 2 <input type="checkbox"/>	Nuk ka ndikim 3 <input type="checkbox"/>	Nuk e di/ Refuzim 99 <input type="checkbox"/>
Media				
Organizatat studimore të shoqërisë civile				
Universitetet				